



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 189 /2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ymer Hoxha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Kaçanik, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Kaçanik, për shkak të ndikimit në votues gjatë procesit të votimit, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Kaçanikut, në seancën e panelit të mbajtur me 21.06.2012, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Kaçanik.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 18.06.2012, nga subjekti politik LVV, me të cilën pretendohet se më datën 17.06.2012, përballë Qendrës së Votimit (QV), Shkolla “7 Shtatori” rreth orës 10:05, Xhelal Gashi - kryesues i Asamblesë së Kuvendit dhe Ramadan Luzha, kanë qëndruar në një lokal përball QV, duke pirë kafe dhe siç potencon ankuesi duke bërë presion tek qytetarët për të votuar për subjektin politik PDK. Parashtruesi i ankesës pretendon se me këtë rast personat e sipër përmendur kanë bërë shkelje të Rregullës Zgjedhore 13/2009 neni 7 par. 1 pika b, si dhe Kodit Penal neni 177, ku përcaktohet përcaktimi i lirë i votuesve.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si dëshmi një fotografi .

PZAP-i, e informoi subjektin politik PDK në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 18.06.2012, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 19.06.2012, në ora 15:00.

Në përgjigjen në ankesë te subjektit politik PDK potencohet se Xhelal Gashi, në asnjë kohë nuk është parë dhe as që ka hyrë brenda hapësirës së oborrit të shkollës. Sipas përgjigjes nga subjekti politik PDK se ai ka qëndruar një kohë bashkë me Ramadan Luzhën, derisa kanë pirë nga një lëng në një lokal (shitore) privat në fshat,

dhe shitorja është jashtë rrethojës së objektit shkollor e cila frekuentohet vazhdimisht.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Sipas ankesës së parashtruar në PZAP pala ankuese pretendon se kryesuesi i Asamblesë së Kuvendit Xhelal Gashi dhe Ramadan Luzha në një lokal pranë QV-së në Shkollën “7 Shtatori”, siç potencon ankuesi kanë bërë presion tek qytetarët për të votuar për subjektin politik PDK.

PZAP-i vlerësoi se pretendimet ankimore se janë bërë shkeljet e theksuara në ankesë janë të pabazuara nga shkakut se nuk janë ofruar dëshmi bindëse për tu vërtetuar se ka ndodhur shkelja e pretenduar në ankesë, pasi që nga foto e ofruar si dëshmi që gjenden në shkresat e lëndës nuk mund të identifikohet se lokali për të cilën bëhet fjalë se është afër Shkollës në të cilën është edhe QV siç pretendohet në ankesë dhe po ashtu nuk ka ndonjë dëshmi që do të vërtetohej se personi në fjalë ka bërë presion tek votuesit. Prandaj PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë dhe në kuptim të nenit 115.1 lidhur me 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartpërmendur u vendosi si në dispozitiv të këtij vendim.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

A nr. 189 /2012 më datën 21.06.2012.

Kryesuesi i Panelit
Ymer Hoxha

